



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E DREJTËSISË

MINISTRI

Nr. 5246 / Prot.
2

Tiranë, më 22 07 / 2019

URDHËR

Nr. 386, Datë 22.07.2019

“PËR

HEQJEN E LICENCËS SË USHTRIMIT TË PROFESIONIT TË NOTERIT, NOTERES ALKETA HYSAJ”

Në mbështetje të nenit 102, pikës 4, të Kushtetutës, të nenit 6, të ligjit nr. 8678, datë 14.05.2001, “Për Organizimin dhe Funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar, të nenit 21, pika 1, shkronja “a)”, dhe nenit 67, të Ligjit Nr. 110/2018 “Për noterinë”, nisur nga administrimi i kërkesës së noteress Alketa Hysaj për heqje dorë nga ushtrimi i profesionit të noterit, administruar pranë Ministrisë së Drejtësisë me nr. prot. 5246, datë 11.07.2019,

KONSTATOJ:

Përmes shkresës së administruar nga Ministria e Drejtësisë me nr. 5246 prot., datë 11.07.2019, noterja Alketa Hysaj, e cila ka fituar të drejtën e ushtrimit të profesionit të noterit bazuar në Urdhër Nr. 522, datë 17.12.2012 të Ministrit të Drejtësisë “*Pë dhënien e licencës së ushtrimit të profesionit të noterit dhe përcaktimin e njesisë vendore të ushtrimit të veprimtarisë noteriale*”, ka paraqitur kërkesën e saj për heqje dorë nga ushtrimi i profesionit të noterit.

Ligji Nr. 110/2018 “Për Noterinë” në nenin 21, gërma “a”, parashikon heqjen e licensës së ushtrimit të profesionit të noterit përmes Urdhrit të Ministrit të Drejtësisë, kur noteri heq dorë nga ushtrimi i profesionit të noterit, me kërkesën e tij.

Sipas nenit 67, të Ligjit Nr. 110/2018 “Për Noterinë”, dhe konkretisht pikës 1 dhe 2 të tij, në rast të mbylljes së përkohshme ose të përhershme të një zyre noteriale, arkivi i noterit në largim merret nga noteri që plotëson vendin vakant. Nëse një vend vakant mbetet i paplotësuar, dega vendore përkatëse e Dhomës përzgjedh një tjetër noter në atë bashki për të marrë përsipër arkivin, në bazë

e reflektuara në regjistrat noterialë, si dhe të evidentojë çdo mungesë, dhe çdo dëmtim të dokumenteve arkivorë, nëse ka të tilla.

6. Arkivi noterial të merret në dorëzim me procesverbal në bashkëpunim me Dhomën e Noterisë Tiranë dhe Dhomën Kombëtare të Noterisë.

7. Dhoma e Noterisë Tiranë, brenda 5 ditëve nga marrja dijeni e këtij Urdhri, si dhe pas konsultimit me znj. Alketa Hysaj, të përcjellë emrin e noterit për marrjen në dorëzim të arkivit, në përputhje me kërkesat e nenit 67, të ligjit nr. 110/2018 "Për noterinë".

8. Komisioni i Dorëzimit të Arkivit, pas administrimit të emrit të noterit, sipas pikës 7, të këtij Urdhri, merr masa për dorëzimin me procesverbal të arkivës noterit të përcaktuar nga dhoma përkatëse e noterisë, brenda 5 ditëve pune.

9. Ky urdhër, së bashku me të dhënat përkatëse, të regjistrohen në Regjistrin e Noterëve në Ministrinë e Drejtësisë dhe Dhomës Kombëtare të Noterisë, pas kalimit të afatit të ankimit.

10. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Çështjeve Rregullatore të Drejtësisë pranë Ministrisë së Drejtësisë dhe Dhoma Kombëtare e Noterisë, të marrin masat e nevojshme për zbatimin e këtij Urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI
ETILDA GJONAJ (SALIU)



Konceptoi: A. Xake
Pranoi: N. Kaja
Miratoi: K. Treska
Datë: 17.07.2019 kbpje